

Melos Kolshi¹

UDC: 342.533:342.565.2(497.115)
342.533:342.5(497.115)

**KUVENDI I PA KONSTITUAR: FUNKSIONALITETI INSTITUCIONAL
DHE GJYKATA KUSHTETUESE**

**НЕ КОНСТИТУИРАНОТО СОБРАНИЕ: ИНСТИТУЦИОНАЛНА
ФУНКЦИОНАЛНОСТ И УСТАВЕН СУД**

**THE UNCONSTITUTED ASSEMBLY: INSTITUTIONAL
FUNCTIONALITY AND THE CONSTITUTIONAL COURT**

Abstract

This paper examines the process of constituting the IX Legislature of the Assembly of the Republic of Kosovo following the February 9, 2025 elections, focusing on the political and institutional obstacles that hindered the normal functioning of state institutions. The research analyzes the non-approval of the Report on the Verification of Mandates, disputes concerning the election of the Speaker and Deputy Speakers, as well as the holding of dual positions by individuals in violation of the law. The findings indicate that these disagreements and differing interpretations of constitutional provisions have obstructed the formation of the Government, the adoption of legislation, and the implementation of public policies, thereby jeopardizing Kosovo's international credibility and European integration. The paper also highlights the pivotal role of the Constitutional Court in ensuring institutional functionality and draws lessons for improving parliamentary practices and upholding the rule of law.

Keywords: *Constitution of the Assembly, institutional deadlock, IX Legislature, Assembly of Kosovo, Constitutional Court, rule of law, institutional functionality, parliamentary politics*

¹ Ph.D Candidate (Law). Constitutional and Administrative Law. South East European University, Tetovo, North Macedonia. mk32390@seeu.edu.mk. <https://orcid.org/0009-0001-2618-5256>

Hyrje

Procesi i konstituimit të Legjislaturës së IX-të të Kuvendit të Republikës së Kosovës pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 ka reflektuar një sfidë të rëndësishme institucionale dhe politike për vendin. Seancat konstituive, të cilat kanë për natyrë të jenë procedurale dhe formale, u shndërruan në mekanizma bllokimi për shkak të jodakordësisë ndërmjet partive kryesore parlamentare dhe interpretimeve të ndryshme të dispozitave kushtetuese. Mosvotimi i Raportit për Verifikimin e Mandateve, kontestet mbi zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkryetarëve, si dhe kombinimi i dy pozitave nga disa individë në shkelje të ligjit, dëshmuar ndikimin e drejtpërdrejtë të mosbashkëpunimit politik në funksionimin normal të institucioneve.

Kjo situatë ka pasur pasojat të menjëhershme për funksionimin e shtetit, duke penguar formimin e Qeverisë, miratimin e ligjeve dhe zbatimin e politikave publike, si dhe duke minuar besueshmërinë ndërkombëtare dhe perspektivën evropiane të Kosovës. Për më tepër, vonesat në miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe planeve të zhvillimit, si Plani i Rritjes 2024-2027, rrezikojnë humbjen e fondeve strategjike dhe pengojnë integrimin evropian të vendit.

Ky punim synon të analizojë fazat e konstituimit të Legjislaturës së IX-të, vështirësitë politike dhe institucionale që u shfaqën gjatë këtij procesi, ndikimin e mosrespektimit të rregullave kushtetuese dhe ligjore, si dhe pasojat e bllokadës për funksionimin e shtetit dhe perspektivën e Kosovës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Analiza fokusohet në ndërveprimin ndërmjet procedurave parlamentare, rolit të partive politike dhe ndërhyrjes së Gjykatës Kushtetuese, duke nxjerrë mësim për përmirësimin e praktikave institucionale dhe respektimin e sundimit të ligjit.

Zhvillimi i seancës

Në fazën fillestare të procesit, pas zgjedhjeve, seanca konstituive u ndërpre qysh në hapin e parë procedural, pasi Kuvendi nuk arriti të votojë Raportin e Komisionit për Verifikimin e Mandateve të deputetëve. Miratimi i raportit ishte kusht themelor për të vazhduar me pikat tjera të rendit të ditës lidhur me formimin e legjislaturës së re. Megjithatë, tri prej subjekteve kryesore parlamentare - PDK, LDK dhe AAK - refuzuan ta votojnë raportin, duke argumentuar se ai ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Sipas tyre, raporti nuk mund të miratohej

përderisa Kryeministri në detyrë dhe ekzekutivi aktual nuk kishin dhënë dorëheqje para se të certifikoheshin mandatet e deputetëve të rinj.²

Mosvotimi i raportit bllokoi menjëherë procedurën, pasi pa verifikimin e mandateve, Kuvendi nuk mund të lëvizte drejt zgjedhjes së Kryetarit dhe Nënkryetarëve të Kuvendit. Kjo ndërprerje e hershme e seancës konstituive u bë tregues i qartë i vështirësive politike që do të shoqëronin të gjithë procesin e konstituimit të Legjislaturës së IX-të. Pas konsultimeve dhe dakordimit të partive politike, ata u pajtuan që ta votojnë këtë raport dhe të vazhdohet tutje.

Procesi i konstituimit të Legjislaturës së IX-të të Kuvendit të Republikës së Kosovës pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 u karakterizua nga një bllokadë e zgjatur institucionale. Që nga seanca e parë, u bë e qartë se deputetët nuk po arrinin të siguronin bashkëpunimin e nevojshëm ndërpartiak për të përmbushur hapat e kërkuar kushtetues dhe procedural për konstituimin e Kuvendit. Probleme kishte tek votimi i Raportit për Verifikimin e Mandatave, ku pas kërkesës së AAK-së drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kjo çështje u zgjidh.³

Pas votimi të Komisionit për Verifikimin e mandateve, Mospajtimet politike rreth postit të Kryetarit të Kuvendit u shndërruan në pengesën kryesore, duke e zhvendosur procesin nga një procedurë formale parlamentare në një ngërç të vazhdueshëm politik. Partia fituese në zgjedhjet e fundit, kërkonte që votimi i Kryetarit të Kuvendit të bëhet jashtë praktikës së deritanishme, në mënyrë të fshehtë, ndërsa partitë e tjera kundërshtonin.

Në mungesë të një marrëveshjeje politike, çështja u shty drejt interpretimit kushtetues. Gjykata Kushtetuese, përmes një vendimi squares, përcaktoi tre parime themelore: (1) posti i Kryetarit të Kuvendit i takon partisë së parë fituese të zgjedhjeve; (2) kandidati për këtë pozitë mund të vihet në votim deri në tre herë; dhe (3) Kuvendi nuk mund të konsiderohet i konstituar pa zgjedhjen e Kryetarit dhe të gjithë Nënkryetarëve, ashtu siç e kërkon Kushtetuta. Ky interpretim krijoi qartësinë juridike të nevojshme për të shmangur lexime të ndryshme të

² PDK, LDK dhe AAK votojnë kundër raportit për verifikimin e mandateve të deputetëve; <https://ekonomiaonline.com/nuk-u-miratua-raport-i-komisionit-te-perkohshem-per-verifikimin-e-mandateve-te-deputeteve/>, (Qasur për herë të fundit më 21.10.2025)

³ Time K. dhe deputetë të tjerë: CASE OF KO124/25. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 26 qershor 2025. (Shih linkun: <https://api.webgjk-ks.org/Custom/4f2913a0-7463-4b56-968d-350b54a65097.pdf>)

dispozitave dhe për të orientuar procesin drejt një zgjidhjeje dhe duke obliguar Kuvendin që brenda 30 ditëve të konstituohet.⁴

Në bazë të këtij interpretimi, më 26 gusht 2025 u arrit zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit, duke plotësuar njërin prej elementeve kyçe të konstituimit. Megjithatë, procesi mbeti i papërfunduar për shkak të vështirësive të reja që u paraqitën në fazën e zgjedhjes së Nënkyetarëve.⁵ Sipas renditjes kushtetuese, secili prej tre grupeve më të mëdha parlamentare duhet të ketë të garantuar nga një Nënkyetar, nga komuniteti serb një nënkryetar dhe nga komunitetet tjera një nënkryetar.⁶ por mungesa e dakordimit brenda subjekteve dhe kundërshtimet ndaj kandidaturave e zvarritën procesin në mënyrë të konsiderueshme. Çështja ngeci tek zgjedhja e nënkryetarit nga radha e komunitetit serb, pasi që partia më e madhe propozoi që nënkryetari serb të votohet ndaras, në kundërshtim me praktikën e deritanishme parlamentare të Republikës së Kosovës. Edhe kjo çështje u trajtua nga Gjykata Kushtetuese, pasi që Kryetari i ri i Kuvendit, i cili vjen nga radha e partisë më të madhe nga zgjedhjet e fundit, e konsideruan Kuvendin e konsitutuar edhe pa zgjedhjen e nënkryetarit serb, ku gjykata ripërsëriti qëndrimin se Kuvendi nuk konsiderohet i konstituuar pa zgjedhjen e kryetarit dhe 5 nënkryetarëve.⁷

Vetëm pas negociatave të zgjatura ndërmjet grupeve parlamentare u krijuan kushtet minimale për mbylljen e procedurës. Më 10 tetor 2025, Kuvendi arriti të zgjedhë edhe Nënkyetarët, duke shënuar zyrtarisht konstituimin e Legjislaturës së IX-të. Me këtë akt u hap rruga për funksionalizimin e plotë të organeve të brendshme të Kuvendit dhe fillimin e punës legjislative për mandatin e ri.⁸

Ky proces i zgjatur tregon se seancat konstituive, përkundër natyrës së tyre kryesisht procedurale dhe formale, mund të shndërrohen në mekanizma të bllokimit institucional kur mungon vullneti politik i

⁴ Memli Krasniqi dhe 12 deputetë të tjerë; Hykmete Bajrami dhe 10 deputetë të tjerë: CASE OF KO193/25 & KO196/25. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 7 gusht 2025. (Shih linkun: <https://api.webgjk-ks.org/Custom/28febcc7-2374-4a49-b5b7-a322e29f3bad.pdf>)

⁵ Radio Evropa e Lirë: “Çfarë ndodhi në seancën konstituive të Kuvendit”, 15 prill 2025. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/kuvendi-kosoves-seanca-konstituive-33385507.html>)

⁶ Neni 67.4, Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 2008. (Shih linkun: https://www.gjk-ks.org/repository/docs/Kushtetuta_e_RK_2008.pdf)

⁷ Igor Simić dhe deputetë të tjerë: CASE OF KO265/25. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. (Shih linkun: <https://api.webgjk-ks.org/Custom/e42461bd-a4ef-4845-b9f7-2e6b86518586.pdf>)

⁸ Radio Evropa e Lirë: “Konstituohet Kuvendi pavarësisht kundërshtimeve të Listës Serbe”, 10 tetor 2025. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/deputetet-kuvendi-nenkryetari-kushtetuesja/33556141.html>)

nevojshëm për bashkëpunim ndërpartiak dhe kur interpretimi i dispozitave kushtetuese bëhet pjesë e konfliktit politik. Ngërçi i krijuar rreth verifikimit të mandateve, votimit të Kryetarit dhe Nënkryetarëve, si dhe mosmarrëveshjet mbi mënyrën e votimit dhe respektimin e praktikave parlamentare të deritanishme, ilustron sesi procesi formal mund të pengohet nga jodakordësia politike. Rasti i Legjislaturës së IX-të të Kuvendit të Kosovës paraqet një shembull të rëndësishëm të ndërveprimit ndërmjet procedurave parlamentare, rolit të partive politike dhe ndërhyrjes së Gjykatës Kushtetuese për të siguruar funksionalitetin institucional. Ai demonstroi se Gjykata, duke interpretuar qartë parimet kushtetuese, mund të vendosë kufij dhe të krijojë kuadër juridik për konstituimin e institucioneve, duke shmangur lëshime që mund të minojnë legjitimitetin dhe funksionimin e Kuvendit, dhe duke siguruar që mekanizmat demokratikë të mos mbeten peng i mosmarrëveshjeve të grupeve politike.

Mbajtja e dy pozitave në të njëjtën kohë

Situata në Kosovë, pas dështimit të Legjislaturës IX për të zgjedhur Qeverinë e re, tregon një problem të qartë institucional: përkundër shpalljes së zgjedhjeve të reja nga Presidentja dhe shpërndarjes së Kuvendit, disa individë kanë vazhduar të mbajnë në të njëjtën kohë pozitën e deputetit dhe atë të anëtarit të Qeverisë. Ky veprim bie ndesh me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, duke krijuar një precedent shumë të rrezikshëm për funksionimin institucional dhe respektimin e ligjit.

Kushtetuta dhe ligji janë të qarta: një person nuk mund të ushtrojë njëkohësisht mandat deputeti dhe pozita ekzekutive në Qeveri. Mandati i deputetit automatikisht ndalon ushtrimin e detyrës ekzekutive, dhe Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë kërkon dorëheqjen e anëtarit të Qeverisë në detyrë para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve. Keqkuptimi ose interpretimi i gabuar i këtij neni nga disa anëtarë të Qeverisë - të cilët kanë argumentuar se Qeveria në detyrë mund të funksionojë pa dorëheqje - nuk i ndryshon këto rregulla: kufizimi i ushtrimit të dy pozitave lidhet me individin, jo me institucionin në tërësi.⁹

Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjen P.A.nr.09/2025 trajton legalitetin e Udhëzimit Administrativ

⁹ Neni 70. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Qershor, 2008.

Nr. 01/2025 të Ministrisë së Financave, i cili kishte për qëllim Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskal. Çështja u paraqit për shqyrtim pasi palët ankues kërkonin shfuqizimin e udhëzimit, duke argumentuar se ai tejkalonte kompetencat ligjore të Ministrisë dhe dëmtonte të drejtat dhe detyrimet e bizneseve dhe qytetarëve. Gjykata e vlerësoi udhëzimin dhe theksoi se akti ishte nxjerrë nga një ministër në detyrë që në të njëjtën kohë ushtronte mandatin e deputetit, gjë që përbën konflikt funksionesh sipas nenit 72 të Kushtetutës së Kosovës. Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi se udhëzimi administrativ ishte i paligjshëm dhe i pavlefshëm.¹⁰

Në arsyetimin e saj, Gjykata theksoi rëndësinë e respektimit të rregullave kushtetuese për ndarjen e pushteteve dhe kufizimin e ndërhyrjeve politike në veprimtarinë e organeve ekzekutive dhe administrative. Vendimi gjithashtu adreson ndikimin praktik të udhëzimit të shfuqizuar mbi bizneset dhe qytetarët, duke vënë në dukje se aktet e tilla nuk duhet të shkaktojnë pasiguri juridike dhe shkelje të të drejtave të garantuara me ligj. Gjykata përcolli se çdo akt administrativ i nxjerrë në mënyrë të paligjshme, sidomos kur krijohet konflikt interesi, duhet të konsiderohet i pavlefshëm dhe i papranueshëm.

Ky vendim ka një mesazh të qartë për ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Gjykata kërkon që të gjitha organet ekzekutive të respektojnë vendimet gjyqësore dhe të shmangin çdo përpjekje për delegitimim ose ndërhyrje në funksionet gjyqësore. Përmes këtij vendimi, Gjykata thekson se mbrojtja e pavarësisë gjyqësore dhe sundimi i ligjit janë thelbësore për funksionimin e drejtë të institucioneve shtetërore, garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe sigurinë juridike të bizneseve dhe institucioneve në Kosovë.

Ndërsa, mosrespektimi i vendimit të Gjykatës Supreme është një praktikë e dëmshme për funksionimin demokratik e ligjor të shtetit. Ky veprim tregon qartë se kombinimi i pozitave është i paligjshëm dhe kërkoi zbatimin e menjëhershëm të rregullave ligjore dhe kushtetuese. Megjithatë, anëtarët e përfshirë nuk e kanë respektuar këtë vendim, duke sfiduar autoritetin e Gjykatës Supreme dhe duke treguar mungesë të përgjegjësisë institucionale. Kjo praktikë dëmton jo vetëm funksionimin e ligjshëm të Qeverisë, por edhe besimin publik në institucionet shtetërore e posaçërisht në ato të drejtësisë.

¹⁰ AKTGJYKIM P.A.nr. 09/2025. Gjykata Supreme e Kosovës. Publikuar më 22.07.2025. https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP__09-2025_SQ.pdf

Mesazhi i kësaj situatë është i qartë, kur individë vendosin të mbajnë dy pozita njëkohësisht në shkelje të ligjit dhe në kundërshtim me vendimet e gjykatës, krijohet një precedent shumë i rrezikshëm për vendosjen e sundimit të ligjit. Kjo rrit mundësinë e bllokadave institucionale dhe i jep mesazhe të gabuara qytetarëve dhe institucioneve për respektimin e ligjit dhe ndarjen e pushteteve. Për më tepër, praktika e tillë minon funksionimin normal të Qeverisë dhe pengon përmbushjen e detyrimeve të saj, duke krijuar një vakum institucional dhe një klimë mosbesimi të thellë ndaj institucioneve të shtetit.

Është thelbësore që të gjithë individët që janë zgjedhur deputetë të japin dorëheqjen nga pozita ekzekutive para certifikimit të mandateve, në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin për Qeverinë. Vetëm kështu mund të garantohen funksionimi legjitim i Kuvendit dhe Qeverisë, respektimi i vendimeve të Gjykatës Supreme dhe stabiliteti institucional i vendit. Mungesa e zbatimit të këtyre rregullave dërgon një sinjal negativ mbi respektimin e ligjit dhe rendin demokratik.

Pasojat e bllokadës

Mospërfundimi i procesit të konstituimit të Kuvendit ka pasoja të drejtpërdrejta dhe të dukshme për funksionimin e shtetit. Pa zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, nuk mund të fillojë procedura për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë. Kjo do të thotë se qeverisja e re ngec që në start, pasi nuk mund të emërohet Kryeministri dhe të caktohen anëtarët e kabinetit qeverisës. Pa këtë hap bazë, procesi politik dhe ekzekutiv mbetet i paralizuar, duke penguar planifikimin dhe zbatimin e politikave publike.

Gjendja e tillë e bën Kuvendin jofunksional, pasi nuk mund të merren vendime ligjore, të emërohen organet e pavarura, ose të kontrollohet ekzekutivi në detyrë. Çdo përpjekje për të realizuar detyrat kushtetuese pengohet nga mungesa e kuorumit dhe nga bllokimi i procedurave themelore. Pa konstituimin e plotë, Kuvendi nuk mund të kryejë funksionet e tij kryesore për mbikëqyrje, ligjvënje dhe kontroll institucional.

Një tjetër pasojë e rëndësishme është se thellohet kriza institucionale. Mospërmbushja e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore nga Kuvendi krijon precedent të rrezikshëm për mosrespektimin e rregullave demokratike dhe minon besimin e qytetarëve në institucionet publike. Kjo gjendje mund të çojë në vonesa në ofrimin e shërbimeve publike, ndërprerje të mbikëqyrjes institucionale dhe dobësim të

llogaridhënies së institucioneve, duke rrezikuar stabilitetin politik dhe juridik të vendit.

Në përmbledhje, moskonstituimi i Kuvendit nuk është vetëm një çështje procedurale, por ka pasoja të menjëhershme për formimin e Qeverisë, funksionimin e legjislativit dhe stabilitetin institucional. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme politike dhe juridike për të rikthyer funksionalitetin e plotë të institucioneve dhe për të garantuar vazhdimësinë e mekanizmave demokratikë në vend.

Gjatë Legjislaturës VIII të Kuvendit të Republikës së Kosovës, procesi i emërimit të organeve kolegjiale dhe individuale që varen nga Kuvendi ka përjetuar ngecje serioze, duke krijuar një efekt dominues në funksionimin e institucioneve publike. Shumë institucione mbetën jofunksionale ose me mungesa të anëtarëve përkatës, për shkak të mosveprimit të Kuvendit dhe vonesave të Qeverisë për propozimet e nevojshme. Edhe pse disa procedura janë zbatuar me përpikëri, shumica parlamentare nuk arriti t'i finalizojë emërimet brenda afateve kushtetuese dhe ligjore, duke i lënë organet pa përbërjen e plotë.

Kjo situatë ka rezultuar në pengesa të ndjeshme për funksionimin e institucioneve kyçe, përfshirë pasi që përbërja e tyre varet nga Kuvendi, Gjykatën Kushtetuese, Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, Komisionin e Pavarur për Media dhe disa agjenci të tjera. Shumica e këtyre organeve nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje, gjë që ka çuar në moszbatimin efektiv të ligjeve dhe ndërprerje të mbikëqyrjes institucionale. Për më tepër, disa mandate po përfundojnë gjatë vitit 2025, duke rritur rrezikun për jofunksionalitet dhe përkeqësuar vakumin institucional.

Në nivel politik, përgjegjësia kryesore i takon shumicës parlamentare të kaluar, e cila kishte fuqinë dhe përgjegjësinë për të garantuar emërimet në kohë, por ka zgjedhur të mos veprojë. Kjo ka krijuar precedent të rrezikshëm për mosrespektimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, duke minuar besimin e qytetarëve në institucionet publike dhe duke rrezikuar stabilitetin demokratik.

Moskonstituimi i Kuvendit po ashtu ka penguar miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare kyçe, përfshirë Planin e Rritjes 2024-2027, i cili ka një vlerë prej mbi 800 milionë eurosh dhe synon të nxisë zhvillimin ekonomik, investimet infrastrukturore dhe afrimin e Kosovës me standardet e Bashkimit Evropian. Vonesa në miratimin e këtij plani i

mohon vendit një mundësi të jashtëzakonshme për të siguruar rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të kushteve të jetesës për qytetarët.¹¹

Për më tepër, kjo situatë ka bllokuar edhe marrëveshjet me partnerë strategjikë si Banka Botërore, Gjermania, Franca dhe vende të tjera që janë të gatshme të mbështesin Kosovën. Vonesa në miratimin e këtyre marrëveshjeve dëmton drejtpërdrejt sektorë kyç si zhvillimi ekonomik, infrastruktura, energjia e gjelbër, arsimi dhe shëndetësia, duke minuar gjithashtu besueshmërinë ndërkombëtare dhe perspektivën evropiane të vendit.

Partnerët ndërkombëtarë kanë bërë të qartë pritshmërinë e tyre për një Kuvend funksional dhe një partner legjitim që të çojë përpara projektet e përbashkëta. Pa një Kuvend të konstituuar, Kosova rrezikon jo vetëm humbjen e mbështetjes financiare dhe politike, por edhe pengimin e procesit të integritimit evropian në një moment vendimtar për të ardhmen e vendit.¹²

Conclusion

The prolonged failure to constitute the IX Legislature of the Assembly of the Republic of Kosovo demonstrates the critical impact of political disagreements and institutional obstacles on the functioning of state institutions. The initial deadlock over the Verification of Mandates Report, disputes regarding the election of the Speaker and Deputy Speakers, and the illegal holding of dual positions by some individuals illustrate how procedural and formal parliamentary sessions can be transformed into mechanisms of institutional paralysis when political will and inter-party cooperation are lacking.

The Constitutional Court played a decisive role in clarifying constitutional provisions and setting legal parameters for the proper functioning of the Assembly. Its interventions ensured that the principles of constitutionality, rule of law, and institutional accountability were upheld, providing a framework to overcome political deadlocks and complete the legislative constitutive process.

¹¹ Kosova rrezikon të mbetet pa fonde nga Plani i Rritjes i BE-së. Radio Evropa e Lirë. <https://www.evropaelire.org/a/kosova-rrezikon-te-mbetet-pa-fonde-nga-plani-i-rritjes-i-bllokut-evropian/33565994.html> (Qasur për herë të fundit më 30 tetor 2025).

¹² Rohde dhe Orav: Erdhëm me shpresë të madhe se do të konstituohet Kuvendi. Demokracia. <https://demokracia.com/rohde-dhe-orav-erdhem-me-shprese-te-madhe-se-do-te-konstituohet-kuvendi/> (Qasur për herë të fundit më 28 shtator 2025).

The institutional paralysis resulting from the delayed constitution of the Assembly had immediate and tangible consequences: the formation of the Government was obstructed, the adoption of legislation and public policies was delayed, and key international and strategic agreements were postponed. This not only undermined Kosovo's international credibility but also jeopardized its European integration and the effective delivery of public services.

The case of the IX Legislature underscores the importance of political responsibility, adherence to constitutional provisions, and respect for judicial decisions in maintaining institutional stability. Ensuring that no individual simultaneously holds legislative and executive positions, and that parliamentary procedures are followed faithfully, is essential for safeguarding the legitimacy of the Assembly and the Government.

Ultimately, this experience offers important lessons for strengthening parliamentary practices, preventing institutional deadlocks, and reinforcing the rule of law. A functional, constitutionally compliant legislature is essential for Kosovo's democratic governance, institutional resilience, and sustained international and European integration.

Recensentë:

Prof. dr. Florent Muqaj

Prof. dr. Jeton Shasivari

Bibliography:

1. Time K. & other deputies. (2025, June 26). *CASE OF KO124/25*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Retrieved from <https://api.webgjk-ks.org/Custom/4f2913a0-7463-4b56-968d-350b54a65097.pdf>

2. Memli Krasniqi & 12 deputies; Hykmete Bajrami & 10 deputies. (2025, August 7). *CASE OF KO193/25 & KO196/25*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Retrieved from <https://api.webgjk-ks.org/Custom/28febcc7-2374-4a49-b5b7-a322e29f3bad.pdf>

3. Igor Simić & other deputies. (2025). *CASE OF KO265/25*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Retrieved from <https://api.webgjk-ks.org/Custom/e42461bd-a4ef-4845-b9f7-2e6b86518586.pdf>

4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. (2008). *Neni 67.4 & Neni 70*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Retrieved from https://www.gjk-ks.org/repository/docs/Kushtetuta_e_RK_2008.pdf
5. Gjykata Supreme e Kosovës. (2025, July 22). *AKTGJYKIM P.A.nr. 09/2025*. Retrieved from https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP__09-2025_SQ.pdf
6. Ekonomia Online. (2025, October 21). *Nuk u miratua raport i Komisionit të përkohshëm për verifikimin e mandateve të deputetëve*. Retrieved October 21, 2025, from <https://ekonomiaonline.com/nuk-u-miratua-raport-i-komisionit-te-perkohshem-per-verifikimin-e-mandateve-te-deputeteve/>
7. Radio Evropa e Lirë. (2025, April 15). *Çfarë ndodhi në seancën konstituive të Kuvendit*. Retrieved from <https://www.evropaelire.org/a/kuvendi-kosoves-seanca-konstituive-/33385507.html>
8. Radio Evropa e Lirë. (2025, October 10). *Konstituohet Kuvendi pavarësisht kundërshtimeve të Listës Serbe*. Retrieved from <https://www.evropaelire.org/a/deputetet-kuvendi-nenkryetari-kushtetuesja/33556141.html>
9. Radio Evropa e Lirë. (2025, October 30). *Kosova rrezikon të mbetet pa fonde nga Plani i Rritjes i BE-së*. Retrieved from <https://www.evropaelire.org/a/kosova-rrezikon-te-mbetet-pa-fonde-nga-plani-i-rritjes-i-bllokut-evropian/33565994.html>
10. Demokracia. (2025, September 28). *Rohde dhe Orav: Erdhëm me shpresë të madhe se do të konstituohet Kuvendi*. Retrieved from <https://demokracia.com/rohde-dhe-orav-erdhem-me-shprese-te-madhe-se-do-te-konstituohet-kuvendi/>